



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 297 Akti

Nr. 349 Vendimi
Tiranë, më 22.2.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Brunilda Bekteshi

Kryesuese

Roland Ilia

Relator

Etleđa Çiftja

Anëtare

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Gledis Hajdini, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 22.2.2021, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Izet Salaj**, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Apelit Gjirokaštër.

BAZA LIGJORE:

Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Neni “G” i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrativ i Republikës së Shqipërisë”;

Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Izet Salaj, gjatë periudhës së fillimit të procesit të hetimit administrativ ka ushtruar detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë. Për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Izet Salaj, u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt në shortin e hedhur në mars të vitit 2019, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit” – nga i cili rezultoi se do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 3, i përbërë nga komisionerët, Brunilda Bektashi, Alma Faskaj dhe Roland Ilia. Relator i çështjes me short u zgjodh komisioner, z. Roland Ilia.

2.1 Me vendimin nr. 1, datë 25.3.2019, kryesuese e trupit gjykues u zgjodh komisionere Brunilda Bektashi. Me vendimin e Komisionit nr. ***, datë 9.3.2020, “Për rishpërndarjen me short të çështjeve të vitit 2018 dhe 2019 të Komisionerit Alma Faskaj” dhe vendimin nr. ***, datë 9.3.2020, “Për rishpërndarjen me short dhe transferimi e çështjeve të Komisionerit Alma Faskaj me cilësinë e anëtarit të trupit gjykues të caktuara me procedurat e shortit të muajit shtator, nëntor 2018 dhe janar, mars dhe nëntor 2019”, anëtar i ri zëvendësues për këtë çështje u zgjodh komisionere Etleda Çiftja.

2.2 Anëtarët e trupit gjykues deklaruan mungesën e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

3. Procesi i rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Izet Salaj, ka filluar në respektim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016.

4. Konstatohet se subjekti Izet Salaj, ka ushtruar funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë.

5. Subjekti i rivlerësimit, z. Izet Salaj, me shkresën e datës 5.1.2021 drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor, ka kërkuar mbarimin e statusit të magjistratit nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes, duke shpjeguar dhe arsyet e tij.

6. Në vijim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit administroi shkresën¹ e Këshillit të Lartë Gjyqësor, me anë të së cilës përcillej vendimi “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, z. Izet Salaj”.

7. Komisioni vëren se Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në nenin 61, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar dhe në pikën 3, të nenit 65, të ligjit nr.

¹ Shkresa nr. ***prot., datë 25.1.2021, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 25.1.2021.

96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit të rivlerësimit për heqjen dorë nga statusi i magjistratit, me vendimin nr. ***, datë 21.1.2021, vendosi të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit për z. Izet Salaj, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.

II. ARSYET E PËRFUNDIMIT TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

a. Orientimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

8. Kolegji i Posaçëm i Apelimit në lidhje me praktikën e gjykimit të çështjeve që lidhen me institutin e dorëheqjes së subjekteve të rivlerësimit nga procesi në fazën të ndryshme të tij, po kështu edhe pasojat juridike që sjell ndërprerja e procesit, orienton Komisionin që për zgjidhjen e këtyre çështjeve, duke respektuar parimin e transparencës në zhvillimin e procedurës së rivlerësimit, të verifikojë vullnetin e pavesuar për dorëheqjen e dhënë, e cila duhet të ketë burim të ligjshëm një prej institucioneve të caktuara me ligj.

9. Si sanksion kushtetues për raste të ngjashme, Komisioni orientohet që, përveç ndërprerjes së procesit të rivlerësimit, të vendosë edhe ndalimin e emërimit të subjektit të rivlerësimit gjyqtar ose prokuror të çdo niveli, anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor të Lartë të Drejtësisë ose Prokuror të Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare².

b. Verifikimi i vullnetit të pavesuar për dorëheqje

10. Siç e kemi evidentuar më sipër, në Komisionin e Pavaruar të Kualifikimit, në datën 25.1.2021 është depozituar njoftimi i vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor – *për mbarimin e statusit të magjistratit nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes*.

10.1 KLGj-ja bazuar në kërkesën për dorëheqje të bërë nga subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. ***, datë 21.1.2021, ka vendosur deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. Izet Salaj, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë.

Për këtë vendim krahas Komisionit, është njoftuar edhe subjekti i rivlerësimit, z. Izet Salaj.

10.2 KLGj-ja me shkresën nr. ***prot., datë 17.2. 2021, ka konfirmuar se ndaj vendimit nr. ***, datë 21.1.2021, nuk është ushtruar ankim dhe, për rrjedhojë, ky vendim ka marrë formë të prerë.

11. Për sa më sipër, Komisioni vëren se konfirmohet vullneti i pavesuar i subjektit për dorëheqje, pasi z. Izet Salaj, ka paraqitur dorëheqjen para Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe pasi këshilli ka vendosur mbarimin e statusit të magjistratit, subjekti nuk ka paraqitur ankim ndaj këtij vendimi, i cili ka marrë formë të prerë.

c. Ligji i zbatueshëm për ndërprejen e procedurës së rivlerësimit

12. Në germën “a”, pika 1, të nenit 64, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet se statusi i magjistratit mbaron kur jep dorëheqjen.

² Referohuni vendimit nr. 1/2018 (JR), datë 11.6.2018, paragrafëve 96 dhe 97 të tij, të KPA-së.

13. Neni 65, i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar procedurën që duhet ndjekur për mbarimin të statusit të magjistratit nëpërmjet dorëheqjes, si vijon:

“1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës.

2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit.”

14. Neni G, i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen, si vijon:

“1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet.

2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”.

15. Neni 56, i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar të drejtën e dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit, si vijon:

“1. Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të japë dorëheqjen nga detyra jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Dorëheqja i paraqitet me shkrim Presidentit të Republikës dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të këtij institucioni. Në rastin e dorëheqjes, Komisioni merr vendim për pushimin e procedurës së rivlerësimit.

2. Pas dhënies së dorëheqjes, subjekti i rivlerësimit, ka të drejtë të përfitojë pagesë kalimtare, sipas nenit 7, pika 1, të ligjit “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”.

16. Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 43, ka interpretuar, ndër të tjera, lidhjen ndërmjet këtyre dy dispozitave, si vijon:

“[...] Neni 56 i ligjit i jep mundësinë subjektit që dorëhiqet brenda afatit 3-mujor, të përfitojë pagesë kalimtare sipas parashikimeve ligjore në fuqi, mundësi të cilën nuk e përfitojnë subjektet që e japin dorëheqjen pas përfundimit të këtij afati. Gjykata thekson se, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G, të Aneksit të Kushtetutës [...]”.

17. Me paraqitjen e kërkesës nga subjekti i rivlerësimit dhe me shkresën e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Komisioni është vënë në dijeni të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit, z. Izet Salaj,

“nga funksionet e magjistratit” dhe të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor për mbarimin e këtij statusi në datën 28.2.2021.

18. Me e-mail-in e datës 16.2.2021, subjekti i rivlerësimit deklaroi se:

“Ju bëj me dije se nuk kam ushtruar ankim ndaj vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak se i qëndroj vullnetit tim të shprehur në aktin për parashtrimin e dorëheqjes. Nuk dëshiroj të paraqitem në seancë dëgjimore. Jam dakord që procesi i rivlerësimit të ndërpritet sipas ligjit. Me konsideratë Izet Salaj”.

19. Në këto kushte, referuar fakteve të evidentuara me lart, trupi gjykues çmon se procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Izet Salaj, duhet të ndërpritet sipas nenit G, të Aneksit të Kushtetutës.

20. Për sa më sipër, në referim të germës “b”, të nenit 89, të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioni vleron se procedura administrative për këtë subjekt mund të mbyllet pa nevojën e zhvillimi të seancës dëgjimore.

21. Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit ka shfrytëzuar të drejtën që i njeh Kushtetuta për dorëheqje. Ndërprerja e procesit të rivlerësimit për shkak të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative dhe, si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit humbet të drejtën për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin G, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 57, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë se procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Izet Salaj, është ndërprerë.
2. Të deklarojë humbjen e së drejtës së këtij subjekti për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.

5. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall, në datën 22.2.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Brunilda BEKTESHI
Kryesuese

Roland ILIA
Relator

Etleda ÇIFTJA
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Gledis Hajdini